



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Adresa: Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 9

Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al

Për: **OE “LA-OR” sh.p.k.,** me **NIPT K71420003R**
Adresa: Autostrada Tiranë - Elbasan, Km. 6, “PALMA NOVA”,
Bërzhitë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” - me mjete elektronike – Punë

Numri i referencës i procedurës: REF-89815-03-11-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Furnizim dhe Vendosje Shunt Reaktor 400 kV 120 MVAr, Sistemit Total të monitorimit të tij, Konfigurimin në sistemin SCADA, furnizimin dhe vendosjen e traktit 400 kV në N/St. Tirana 2, si dhe kryerja e të gjitha punimeve civile në lidhje me këtë projekt”

Kohëzgjatja e kontratës: 15 (pesëmbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 16.03.2021, Nr. 38.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Fondi Limit: 542,291,211 (pesëqind e dyzet e dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 19.04.2021

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 2 (dy) ofertues, me vlerë përkatëse të ofruar:

1. OE “LA-OR” sh.p.k., me **NIPT K71420003R**

Me ofertë ekonomike 538,936,701.01 (pesëqind e tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e një pikë zero një) Lekë pa TVSH me vlerë Lekë pa TVSH.

2. OE “EVEREST” sh.p.k., me NIPT J78311921L

Me ofertë ekonomike 541,766,349.31 (pesëqind e dyzet e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzet e nëntë pikë tridhjetë e një) Lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “EVEREST” sh.p.k., me NIPT J78311921L, për arsye se:

- Nuk ka paraqitur Shtojcën 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/b të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Shtojcën 1.1 “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur”.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/ç të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Shtojcën 5 “Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike”.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/d të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Shtojcën 7 “Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit”.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/dh të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Shtojcën 8.1 “Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/f të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Shtojcën 10 “Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve”.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/g të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Shtojcën 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces”.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.11 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi deklarata për garancinë e kërkuar nga prodhuesi i Shunt Reaktorit është paraqitur në anglisht, ndërkohë referuar pikës 4.6 të Njoftimit të Kontratës, gjuha për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje është gjuha shqipe.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.14 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar, katalogu dhe testimet zyrtare, janë paraqitur në anglisht, ndërkohë referuar pikës 4.6 të Njoftimit të Kontratës, gjuha për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje është gjuha shqipe.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.16 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.17 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur të dhënat e nevojshme për verifikimin e gjendjes gjyqësore për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë (përfshirë të gjithë drejtuesit teknike që janë të pasqyruar në licencën e shoqërisë).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “LA-OR” sh.p.k., me NIPT K71420003R**, me adresë: Autostrada Tiranë - Elbasan, Km. 6, “PALMA NOVA”, Bërzhitë, Tiranë; se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **538,936,701.01 (pesëqind e tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e një pikë zero një) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.04.2021.

Ankesa: Jo.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova